



Republika e Kosovës  
Republika Kosova / Republic of Kosovo  
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor  
Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit / Kancelarija Glavnog Državnog Tužioca / Office of the Chief State Prosecutor



# PLANI I PUNËS

## 2024



# Prokurori i Shtetit

Plani i punës për vitin 2024



## Përmbajtja:

Përmbledhje ekzekutive .....	4
Mandati i Prokurorit të Shtetit .....	5
Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit .....	6
Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit: .....	7
Vlerat .....	9
Objektivat e Prokurorit të Shtetit .....	10
Rritja e efikasitetit në trajtimin dhe luftimin e veprave penale përfshirë ato me theks të veçantë .....	11
Nënobjektivat: .....	12
Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar.....	14
Nënobjektivat: .....	15
Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, veçmas nga regjistri PPP .....	16
Nënobjektivat: .....	18
Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale .....	19
Nënobjektivat: .....	20
Rritja e transparencës, forcimi i besimit të publikut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional.....	21
Nënobjektivat: .....	22
Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar .....	23
Nënobjektivat: .....	24
Ngritja e kapaciteteve profesionale të administratës dhe unifikimi i praktikave .....	25
Nënobjektivat: .....	26
Zbatimi dhe mbikëqyrja e planit të punës .....	27

## Përmbledhje ekzekutive

Prokurorit i Shtetit me qellim të ushtrimit të mandatit ligjor, në zbatim të kompetencave dhe përgjegjësiwe ligjore dhe kushtetuese si dhe Planit strategjik të Sistemit Prokurorial, ka hartuar Planin Vjetor të Punës për vitin 2024.

Plani ka për qellim funksionimin efikas, ngritjen, avancimin dhe profesionalizmin e punës së Prokurorit të Shtetit.

Plani i Punës për vitin 2024 përmban pjesën hyrëse, në të cilën përshkruhet mandati, përgjegjësitë dhe struktura organizative e Prokurorit të Shtetit, përfshirë vizionin dhe misionin e tij.

Pjesa e dytë e planit ka përcaktuar objektivat e Prokurorit të Shtetit për vitin 2024, me të cilat synohet avancimi i sistemit të punës, mbikëqyrjes dhe llogaridhënies në institucionin e Prokurorit të Shtetit.

Në pjesën e tretë të planit objektivat janë konkretizuar në formë tabelare përmes aktiviteteve, treguesve, bartësve të aktiviteteve dhe afateve kohore për realizimin e objektivave.

Zbatimi i këtij plani mundëson përmbushjen e kompetencave dhe përgjegjësiwe kushtetuese dhe ligjore të Prokurorit të Shtetit.



## Mandati i Prokurorit të Shtetit

Prokurori i Shtetit është institucion kushtetues, i pavarur, kompetent dhe përgjegjës për hetimin dhe ndjekjen e kryesve të veprave penale.

Prokurori i Shtetit dhe secili prokuror para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjykime për të gjithë personat, pa asnjë diskriminim, duke respektuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, legjislacionin në fuqi dhe konventa ndërkombëtare.

Prokurori është i autorizuar të iniciojë hetime penale, të paraqesë aktakuzë, të zhvillojë ndjekjen penale apo të kryejë detyra apo funksione të tjera prokuroriale që janë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Prokurori i Shtetit pasqyron përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe respekton parimet e barazisë gjinore.

## Përgjegjësitë e Prokurorit të Shtetit

Përgjegjësitë kryesore të Prokurorit të Shtetit përfshijnë:

- ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohen që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
- zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;
- sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në legjislacionin në fuqi dhe kodin e etikës profesionale;
- ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të Prokurorit të Shtetit;
- mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, dhe të pandehurve;
- ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;
- marrjen e vendimeve mbi inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;
- ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;
- ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;
- bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;
- ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.



## Struktura organizative e Prokurorit të Shtetit:

Prokurori i Shtetit ka strukturën organizative si në vijim:

- Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, si instanca më e lartë e Prokurorisë së Shtetit, me kompetenca në tërë territorin e Republikës së Kosovës, përveç mbikëqyrjes dhe monitorimit të punës të prokuroreve të shtetit, ndër marrë edhe veprime juridike për të mbrojtur ligjshmërinë në të gjitha çështjet penale, civile, administrative dhe ekonomike.

Në kuadër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit funksionon edhe Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave si zyrë e pavarur për ofrimin e shërbimeve për viktimat e krimit gjatë procedurave ligjore dhe përfaqësimin e interesave të tyre në sistemin e drejtësisë penale, si dhe Zyra për Rikthimin e Asteve e cila është themeluar në muajin Shkurt 2024.

- Prokuroria e Apelit, e cila është shkallë e dytë dhe ka kompetencë në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me autorizim ligjor për të vepruar dhe përfaqësuar lëndet në Gjykatën e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë e cila vendos për mjetet e rregullta juridike. Poashtu kjo prokurori ka kompetencë për të vendosur rreth ankesave kundër vendimeve për hushje të kallëzimeve penale dhe aktvendimeve për pushim të hetimeve.
- Prokuroria e Apelit ka këto departamente:  
Departamenti e Përgjithshëm;  
Departamenti për të Mitur dhe  
Departamentin për Krime të Rënda.
- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, si organ prokurorial i specializuar, e cila ka juridiksion në tërë territorin e Republikës së Kosovës, me kompetenca dhe përgjegjësi për të hetuar dhe ndjekur krimet që janë në kompetencë të veçantë dhe plotësuese të PRSK-së.



- Prokuroria Speciale ka këto departamente:  
Departamenti për hetimin e Krimeve të Luftës;  
Departamenti për hetimin e Krimit të Organizuar;  
Departamenti për hetimin e Terrorizmit; dhe  
Departamenti për hetimin e Korrupsionit dhe Krimit Financiar.
- Prokuroritë Themelore, të shtrira në territorin e shtatë (7) rajoneve të Kosovës, me kompetencë për të zhvilluar hetime dhe ndjekje penale, për te ngritur aktakuza dhe për të përfaqësuar në Gjykatat Themelore si gjykata të shkallës së parë.
- Prokuroritë Themelore kanë këto departamente:  
Departamentin e Përgjithshëm;  
Departamentin për të Mitur dhe  
Departamentin për Krime të Rënda.

Në kuadër të Prokurorisë Themelore të Prishtinës vepron Njësiti për Krime Ekonomike dhe Korrupsion në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda.



## Vlerat

Prokurori i Shtetit si institucion i pavarur karakterizohet nga vlerat si në vijim:

- Profesionalizmi, llogaridhënia, pavarësia në punë dhe transparencia;
- Integriteti dhe etika e lartë;
- Paanshmëria, përkushtimi dhe objektiviteti në trajtimin e rasteve penale bazuar në standarde më të larta vendore dhe ndërkombëtare;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë në punë dhe përdorimi racional i resurseve;
- Promovimi i bashkëpunimit me akterët e tjerë të sundimit të ligjit.

## Objektivat e Prokurorit të Shtetit

- a) Rritja e efikasitetit në trajtimin dhe luftimin e veprave penale me theks të veçantë:
  - Luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike;
  - Pastrimin e parave dhe krimin e organizuar duke përfshirë armët dhe narkotikët;
  - Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë;
  - Krimet e luftës;
  - Veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje;
  - Luftimin e trafikimit me qenie njerëzore;
  - Krimet kibernetike;
  - Fajdeja;
  - Mbrojtja e ambientit;
  - Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar;
- b) Menaxhimi efikas, mbikëqyrja dhe llogaridhënia e vazhdueshme e punës së kryeprokurorëve dhe prokurorëve;
- c) Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, veçanërisht nga regjistri PPP;
- d) Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale;
- e) Rritja e transparencës, forcimi i besimit të publikut dhe bashkëpunimi ndërinstitucional;
- f) Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar
- g) Ngritja e kapaciteteve profesionale të administratës dhe unifikimi i praktikave.

## **Rritja e efikasitetit në trajtimin dhe luftimin e veprave penale përfshirë ato me theks të veçantë**

Prokurori i Shtetit mbetet i përkushtuar që ndër prioritetet e veçanta dhe të vazhdueshme për vitin 2024 do të jetë hetimi dhe ndjekja e kryerësve të veprave penale që ndërlidhen me korrupsionin dhe krimet ekonomike, pastrimin e parave dhe krimin e organizuar, armët dhe narkotikët, veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë, krimet e luftës, veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje, trafikimin me qenie njerëzore, krimet kibernetike, fajdenë dhe mbrojtjen e ambientit.

Prokurori i Shtetit do të angazhohet që të gjitha rastet që ndërlidhen me veprat penale të lartcekura të trajtohen me prioritet të lartë, profesionalizëm dhe efikasitet nga të gjitha nivelet e prokurorive.

Rritja e numrit të prokurorëve në PSRK dhe prokuroritë themelore në trajtimin e këtyre veprave penale

Rritja e efikasitetit në trajtimin dhe luftimin e veprave penale me theks te veçantë:

- Luftimin e korrupsionit dhe krimeve ekonomike;

- Pastrimin e parave dhe krimin e organizuar duke përfshirë armët dhe narkotikët;

- Veprat penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë;

- Krimet e luftës;

- Veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje;

### Profilizimi i prokurorëve

Përgjegjës: KPK, ZKPSH, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

### Avancimi i praktikave ne fuqizimin e bashkëpunimit Polici-Prokurori

Përgjegjës: Kryeprokuroret e prokurorive, Koordinatoret përgjegjës që mbulojnë fushat e caktuara  
Periudha raportuese:  
Janar – Qershor  
Korrik – Dhjetor

### Trajnimet Specifike

Përgjegjës: Akademia e Drejtësisë, Zyra e Trajnimeve në kuadër të Njësitit të Shqyrtimit të Performancës së KPK-së, partnerët dhe projektet ndërkombëtare.  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

### Identifikimi i nevojave për rritjen e numrit të prokurorëve në departamentet përkatëse dhe adresimi pranë mekanizmave të KPK-së

Përgjegjës: Komisioni për Administrimin e prokurorive, ZKPSH, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

- Luftimin e trafikimit me qenie njerëzore;

- Krimet kibernetike;

- Fajdeja;

- Mbrojtja e ambientit;

Fuqizimi i punës në departamentet e PSRK-së, Njësitin për Korrupsion dhe Krim Ekonomik në PTH Prishtinë dhe departamenteve të të gjitha prokurorive, që i trajtojnë veprat penale kundër integritetit seksual dhe dhunës në familje;

Mbikëqyrja e vazhdueshme nga komisioni për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike si dhe Mbikëqyrja e prokurorive nga prokurorët përgjegjës të ZKPSH-së dhe koordinatorët.

### Raportimi i vazhdueshëm për progresin dhe sfidat në trajtimin e veprave penale me theks të veçantë nga ana e kryeprokurorëve dhe koordinatorëve përkatës

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK, PTH dhe koordinatorët  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

### Takimet e kolegjiemeve

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese – çdo muaj

### Bashkërendimi i aktiviteteve me akterët e sundimit të ligjit

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

### Raportet e rregullta, vizitat në të gjitha nivelet e prokurorive, mbikëqyrja e punës dhe raportimi për veprat penale me theks të veçantë

Përgjegjës: komisioni për monitorimin e rasteve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, koordinatorët përgjegjës, kryeprokurorët  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

## **Ngritja e nivelit të sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar**

Sa i përket kësaj objektive në sekuestrimin e aseteve të fituara përmes veprave penale, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2024 do të vazhdoj ta ketë synim dhe të punoj në drejtim të rritjes së cilësisë së akteve të prokurorëve ku propozohet sekuestrimi i aseteve të fituara me vepër penale, në mënyrë që të ketë rezultate edhe në konfiskimin përfundimtar nga ana e gjykatave.

Duke u bazuar në ndryshimet ligjore do të kërkohet kontroll sistematik i rasteve të krimeve ekonomike, korrupsionit, shpëlarjes së parave, terrorizmit, krimit të organizuar të cilat rezultojnë me efikasitet në ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskim përfundimtarë të pasurive të paligjshme.

Për më tepër, Kryeprokurori i Shtetit do të vazhdoj të kërkojë aplikimin e shtuar të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale dhe Udhëzuesit të Thjeshtësuar për Konfiskim në Kosovë.

Prokurori i Shtetit do të ketë bashkëpunim të afërt edhe me institucionet e tjera ligjzbatuese për bashkërendimin e aktiviteteve për të pasur rezultate në sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve të fituara kundërligjshëm.

Kujdes i veçantë do t'i kushtohet sekuestrimit të pasurisë në rastet e veprave penale, në të cilat janë të përfshirë kryerës të profilit të lartë.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit së bashku me Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe në përkrahje të Institutit të Bazelit gjatë vitit 2024 do të themelojnë Zyrën për Rikuperimin e aseteve të fituara me vepër penale.



Rritja e aseteve të sekuestrimit

Mbikëqyrja e vazhdueshme e rasteve me sekuestrim të përkohshëm;

Fuqizimi i bashkëpunimit multidisiplinar për hetimin financiar, konfiskimin e pasurisë, rikthimin e aseteve

Rritja e efikasitetit në zbatimin e ligjit për kompetencat e zgjeruara

Profilizimi i prokurorëve dhe mbështetja nga koordinatorët për sekuestrim dhe konfiskim

Krijimi i mekanizmit për Rikuperimin e Asteve

**Monitorimet dhe raportimet e rregullta**  
Përgjegjës: Kryeprokurorët, Koordinatori Nacional, koordinatorët dhe prokurorët e rasteve, prokurori i caktuar për udhëheqjen e zyrës për rikthimin e aseteve  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Zbatimi i udhëzimeve në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit**  
Përgjegjës: Prokurorët në PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Mbajtja e takimeve të rregullta ndërmjet kryeprokurorëve dhe prokurorëve të rastit**  
Përgjegjës: Kryeprokurori i prokurorisë përkatëse, koordinatorët dhe prokurorët e rasteve:  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Monitorimi i punës së prokurorëve në zbatimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara**  
Përgjegjës: Kryeprokurorët, Koordinatori Nacional dhe koordinatorët e prokurorëve  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Mbikëqyrja e veprimeve të prokurorëve për parashtrimin e kërkesave për sekuestrim dhe konfiskim**  
Përgjegjës: Kryeprokurorët, Koordinatori Nacional dhe koordinatorët e prokurorëve  
Periudha raportuese  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Rritja e numrit të vendimeve për ngrirje dhe sekuestrim**  
Përgjegjës: Kryeprokurorët, prokurorët e rastit dhe koordinatori nacional  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Themelimi dhe funksionalizimi i Zyrës për Rikuperimin e Asteve**  
Përgjegjës: KPK dhe ZKPSH  
Periudha raportuese  
Janar-Dhjetor

## Zvogëlimi i numrit të lëndëve penale, veçmas nga regjistri PPP

Prokurori i Shtetit përgjatë viteve të fundit ka ngritur nivelin e trajtimit të lëndëve penale, duke zvogëluar dukshëm numrin e lëndëve të trashëguara. Kjo tregohet përmes raporteve vjetore të punës ku paraqitet përqindja e lartë e rasteve të kryera, përfshirë këtu edhe vendimet fajësuese të gjykatave. Mirëpo, një problem i vazhdueshëm ka qenë dhe mbetet numri i lartë i lëndëve nga regjistri me kryes të panjohur (PPP), të bartura ndër vite.

Statistikisht ky numër po ndikon negativisht në pasqyrimin real të rezultateve të mira të punës së bërë nga Prokurori i Shtetit. Andaj, objektiv kyç e Prokurorit të Shtetit në vazhdim do të jetë puna në zvogëlimin e këtyre lëndëve. Prokurori i Shtetit ka zvogëluar në masë të konsiderueshme lëndët e trashëguara nga ky regjistër, megjithatë ende mbetet një numër i madh i këtyre lëndëve, në veçanti në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Gjatë vitit 2024, fokusi i Prokurorit të Shtetit do të jetë në zgjidhjen e lëndëve të mbetura në punë nga vitet paraprake, duke përfshirë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për zbulimin e kryesve të veprave penale, si dhe identifikimin e rasteve që kanë arritur parashkrimin.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit do të kërkojë nga prokuroritë themelore dhe PSRK që të hartojnë planet specifike të veprimeve për qasje në zgjidhjen e lëndëve të trashëguara, në veçanti lëndëve me kryes të panjohur dhe atyre me raporte të veçanta, si dhe do të kërkojë nga KPK-ja, që për lëndët PPP të gjendet një zgjidhje rreth statusit të tyre në mënyrë që të mos figurojnë si ngarkesë për Prokurorin e Shtetit, ngase progresi në ndriçimin e këtyre rasteve varet nga veprimet e Policisë së Kosovës,

Prokurori i shtetit do të vazhdoj bashkëpunimi ndërinstucional dhe ngritjen proaktive të këtij bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera relevante në rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe hetimin e kryerësve të panjohur të veprave penale si dhe parashtrimin e kallëzimeve penale me qëllim të arritjes së objektivave të parapara në këtë plan të punës. Prokurori i Shtetit përgjatë viteve të fundit ka ngritur nivelin e trajtimit të lëndëve penale, duke zvogëluar dukshëm numrin e lëndëve të trashëguara. Kjo tregohet përmes raporteve vjetore të punës ku paraqitet përqindja e lartë e rasteve të kryera, përfshirë këtu edhe vendimet fajësuese të gjykatave. Mirëpo, një problem i vazhdueshëm ka qenë dhe mbetet numri i lartë i

lëndëve nga regjistri me kryes të panjohur (PPP), të bartura ndër vite. Statistikisht ky numër po ndikon negativisht në pasqyrimin real të rezultateve të mira të punës së bërë nga Prokurori i Shtetit. Andaj, objektiv kyçe e Prokurorit të Shtetit në vazhdim do të jetë puna në zvogëlimin e këtyre lëndëve. Prokurori i Shtetit ka zvogëluar në masë të konsiderueshme lëndët e trashëguara nga ky regjistër, megjithatë ende mbetet një numër i madh i këtyre lëndëve, në veçanti në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Gjatë vitit 2024, fokusi i Prokurorit të Shtetit do të jetë në zgjidhjen e lëndëve të mbetura në punë nga vitet paraprake, duke përfshirë ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të nevojshme për zbulimin e kryesve të veprave penale, si dhe identifikimin e rasteve që kanë arritur parashkrimin.

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit do të kërkojë nga prokuroritë themelore dhe PSRK që të hartojnë planet specifike të veprimeve për qasje në zgjidhjen e lëndëve të trashëguara, në veçanti lëndëve me kryes të panjohur dhe atyre me raporte të veçanta, si dhe do të kërkojë nga KPK-ja, që për lëndët PPP të gjendet një zgjidhje rreth statusit të tyre në mënyrë që të mos figurojnë si ngarkesë për Prokurorin e Shtetit, ngase progresi në ndriçimin e këtyre rasteve varet nga veprimet e Policisë së Kosovës,

Prokurori i shtetit do të vazhdoj bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ngritjen proaktive të këtij bashkëpunimi me Policinë e Kosovës dhe institucionet tjera relevante në rritjen e efikasitetit në zbulimin dhe hetimin e kryerësve të panjohur të veprave penale si dhe parashtrimin e kallëzimeve penale me qëllim të arritjes së objektivave të parapara në këtë plan të punës.



## Aplikimi i procedurave alternative në zgjedhjen e rasteve penale

Prokurori i Shtetit gjithnjë ka pasur për objektivë aplikimin e procedurave alternative si procedurë e veçantë në zgjidhjen sa më të shpejtë dhe më efektive të rasteve penale.

Ndryshimet e reja ligjore kanë avancuar në aplikimin e procedurave alternative ngase kanë rritur gamën e veprave penale që mund të zgjidhen me ndërmjetësim dhe forma tjera të procedurës alternative.

Kryeprokurori i Shtetit në Planin e Punës edhe për këtë vit ka vendosur t'i kushtojë vëmendje më të shtuar aplikimit më efikas të metodave alternative në zgjidhjen e rasteve penale, duke u përqendruar në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe ndërmjetësimin.

Përdorimi i këtyre metodave mundëson efikasitet dhe efektivitet të procedurës, qasje më të lehtë në drejtësi, ekonomizim të procedurës dhe reduktim të numrit të rasteve në gjyqësor.

Zgjedhja e rasteve në procedura alternative konsiderohet një mundësi shumë efikase që prokurori mund ta përdorë, çdo herë kur të plotësohen kushtet e parapara me ligj, dhe synimi ynë mbetet rritja e numrit të rasteve të referimit me procedura alternative.

Prokurori i Shtetit duke e konsideruar si objektiv në vazhdim ka caktuar nëpër prokurori themelore zyrtarë të ngarkuar me ndërmjetësim, mirëpo synohet që të bëhet rekrutimi i një numri më të madh të zyrtarëve për ndërmjetësim dhe sa i përket aplikimit sa më adekuat të këtyre procedurave, si dhe do të kërkohet fuqizimi i komunikimit mes prokurorisë dhe ndërmjetësuesve.

Rritja e zgjedhjes së rasteve me procedurë alternative do të ndikoj në ekonomizimin e kohës dhe shpenzimeve tjera në sistemin prokurorial, por mbi të gjitha palët do të marrin drejtësi me kohë dhe pa pasur nevojë për procese të stërzgjatura gjyqësore.

Ngritja e efikasiteti në zbatimin e procedurave alternative

**Raportimi i rregullte në kolegji me përfaqësues të zgjedhjen e rasteve përmes aplikimit të procedurave alternative nga prokurorët**

Përgjegjës : Kryeprokurorët dhe Prokurorët e PTH  
Periudha e raportimit  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Rekrutimi i stafit për procedurën e ndërmjetësimit

**Nevoja për rekrutimin e zyrtarëve për ndërmjetësimit në Prokuroritë Themelore**

Përgjegjës : Sekretariati i KPK-së dhe PTH  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Kritja e bashkëpunimit ndërmjet prokurorëve dhe ndërmjetësuesve për aplikimin e procedurave alternative

**Bashkërendimi i veprimeve ndërmjet prokurorëve dhe zyrtarëve për ndërmjetësimit**

Përgjegjës: Prokurorët e rastit dhe zyrtarët për ndërmjetësimit  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Raportimi dhe monitorimi i punës

**Aplikimi i procedura alternative si tregues në vlerësimin e performancës individual të prokurorit**

Përgjegjës: Kryeprokurorët dhe Komisioni për Vlerësimin e Performancës i KPK-së  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Raportimi dhe monitorimi i rregullt për zgjedhjen e rasteve me procedurë alternative**

Përgjegjës: ZKPSH dhe PTH  
Periudha e raportimit  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

## Rritja e transparencës, forcimi i besimit të publikut dhe bashkëpunimi ndërinstytucional


Avancimi i transparencës dhe informimi i publikut mbetet një përkushtim i vazhdueshëm me qëllim që të mbajë të informuar publikun e gjerë lidhur me çështjet me interes të përgjithshëm nga fushëveprimtaria e Prokurorisë së Shtetit. Kjo synohet të bëhet përmes fuqizimit të kapaciteteve njerëzore dhe profesionale, si ngritja e profesionalizmit të zyrtarëve për komunikim publik nëpër prokurori dhe zbatimi i akteve nënligjore që rregullojnë fushën e komunikimit me publikun si indikacion i prekshëm për ngritjen e transparencës, përmes ofrimit të qasjes më të lehtë të qytetarëve, mediave dhe shoqërisë civile në informatat e këtij organi kushtetues.

Hartimi i politikave të reja të komunikimit është nevojë për ngritjen e transparencës, që nënkupton edhe ngritjen e besueshmërisë së publikut në institucionin e Prokurorisë së Shtetit.

Ne do të vazhdojmë të avancojmë komunikimin e brendshëm dhe atë të jashtëm, ku do të angazhohemi që të kemi komunikim proaktiv me mediat dhe shoqërinë civile, si dhe koordinimin me institucionet e tjera të sistemi të drejtësisë të parapara për përmirësimin e komunikimit dhe rritjes së transparencës.

Në vitin 2024, Kryeprokurori i Shtetit synon që në pajtim me Rregulloren për shërbimin e komunikim publik në sistemin prokurorial dhe Strategjinë e komunikimit në sistemin prokurorial të avancojë efikasitetin e mekanizmave të brendshëm për shpërndarjen e informacionit.

Natyrisht, Prokurori i Shtetit duhet të sigurohet që gjatë komunikimit me publikun të sigurojë balancimin në mes të ruajtjes së hetimeve për rastet që është duke i ndjekur penalisht dhe interesit të përgjithshëm për informim të publikut.





## **Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtar**

Prokurori i Shtetit synon që të avancojë bashkëpunimin me të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit në Kosovë me qëllim të realizimit të mandatit ligjor. Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe ato ndërkombëtar, si dhe përkrahja nga partnerët dhe donatorët është shtyllë e rëndësishme në fuqizimin e punës sonë profesionale dhe të pavarur.

Gjithashtu, Prokurori i Shtetit do të fuqizojë bashkëpunimin ndërkombëtar në aspektin e ndihmës Juridike Ndërkombëtare, përmes pjesëmarrjes në konferenca, trajnime dhe forma tjera të organizuara nga forumet e ndryshme ndërkombëtare.

Prokurorit të Shtetit synon që realizimin e këtij bashkëpunimi të bëjë përmes formave të shkëmbimit të ndërsjellë, vizitave studimore, nënshkrimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe informacioneve.

Gjatë viteve paraprake kemi zbatuar politikat e bashkëpunimit profesional dhe proaktiv me institucionet vendore dhe ndërkombëtare. Në këtë drejtim, Prokurori i Shtetit ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe ka fuqizuar koordinimin ndërinstitucional në realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor, me fokus të veçantë në luftimin e dukurive të kundërligjshme.

Bashkëpunimi me institucionet e  
zbatimit të ligjit

Koordinimi dhe bashkërendimi për  
Ndihmë Juridike Ndërkombëtare

**Koordinimi me institucionet e sundimit të ligjit  
për ngritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional**

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Avancimi i bashkëpunimit me prokuroritë e  
vendeve të tjera në luftimin e krimit**

Përgjegjës: ZKPSH, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Koordinimi dhe bashkërendimi i brendshëm lidhur  
me ndihmën juridike ndërkombëtare**

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK, PTH dhe prokurorët e caktuar  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë**

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Koordinimi me donatorët në fushën e sundimit të ligjit**

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Raportimi dhe monitorimi i rregullte për zgjidhjen  
e rasteve me ndihmë juridike ndërkombëtare**

Përgjegjës: ZKPSH, PA, PSRK dhe PTH  
Periudha raportuese:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor



## **Ngritja e kapaciteteve profesionale të administratës dhe unifikimi i praktikave**

Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve profesionale të administratës së Prokurorit të Shtetit është një nga objektivat kryesore të Planit të Punës për vitin 2024. Me anë të kësaj objektive, Prokurori i Shtetit mbështetur nga Sekretariati i Këshillit Prokurorial synon që përmes trajnimeve adekuate të avancojë njohuritë profesionale të stafit që mbështesin punën e Prokurorit të Shtetit. Po ashtu, si qëllim i kësaj objektive është përmirësimi i shërbimeve në administratë me anë të dixhitalizimit të shërbimeve të cilat do të ndikojnë në avancimin, efikasitetin dhe produktivitetin e punës brenda Sistemit Prokurorial të Kosovës.

Trajnime te vazhdueshme ne avancimin e njohurive profesionale

**Identifikimi i nevojave për trajnime për stafin administrative**

Përgjegjës: administratorët e prokurorive  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Unifikimi i raportimit te punës ne PSH

**Hartimi i raporteve unike nga ana e prokurorive**

Përgjegjës: kryeprokurorët, Drejtori i Sekretariatit të KPK-së dhe administratorët  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Planifikimi i nevojave te PSH dhe ZMNV

**Përgatitja e planifikimeve për nevojat e prokurorive**

Përgjegjës: Drejtori i Sekretariatit të KPK-së dhe administratorët  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

Dixhitalizimi i shërbimeve ne punën e PSH

**Aplikimi i SMIL në të gjitha prokuroritë**

Përgjegjës: administratorët dhe zyrtarët e prokurorive  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

**Mbajtja e trajnimeve për përdorimin e SMIL**

Përgjegjës: SKPK-së  
Periudha e raportimit:  
Janar-Qershor  
Korrik-Dhjetor

## Zbatimi dhe mbikëqyrja e planit të punës

Plani i punës bazohet në mandatin ligjor dhe në vizionin e Kryeprokurorit të Shtetit për udhëheqjen e këtij institucioni. Realizimi i këtij plani do të bëhet përmes zbatimit të objektivave, të cilat janë të matshme dhe të arritshme dhe do të realizohen me aktivitete dhe masa konkrete sipas afateve të caktuara.

Plani parashihet vazhdimin e disa aktiviteteve dhe masave, të cilat kanë filluar në vitet paraprake dhe zbatimi i tyre do të vazhdojë edhe këtë vit.

Monitorimi lidhur me zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të Planit të Punës së Prokurorisë së Shtetit për vitin 2024 do të bazohen në dy periudha raportuese Janar-Qershor dhe Korrik-Dhjetor 2024.

Lidhur me veprimet e ndërmarra nga njësitë përgjegjëse të cilat dalin nga ky Plan i Punës, do hartohet edhe Plani i veprimit që do të përcjellë zbatimin e objektivave dhe aktiviteteve të parapara si dhe sfidat eventuale që janë hasur gjatë implementimit të këtyre aktiviteteve.

